

VENDIM
Nr. 32, datë 19.1.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE TË MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME DHE
TË STRUKTURAVE TË SHËRBIMIT
TË JASHTËM NË PROCESIN
E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare, ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të neneve 6, 9, 13 e 14, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda fushës së përgjegjësisë të saj shtetërore:
 - a) ndjek, orienton dhe bashkërendon veprimtarinë e rrjetit të njësive të integrimit evropian në ministritë e linjës;
 - b) merr masat e nevojshme për të siguruar kapacitetet e duhura të shërbimit të jashtëm, në veçanti forcimin e misioneve diplomatike në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, për të siguruar mbështetjen e plotë të procesit të integrimit evropian;
 - c) harton platformën e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
 - ç) merr masat e nevojshme për sigurimin e ekspertizës së nevojshme në mbështetje të komunikimit të procesit të reformave në Shqipëri, në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me normat përkatëse në fuqi për punën me informacionin e klasifikuar.
2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministritë e linjës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama